



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Shkup, 31 maj 2021

Njoftim për shtyp

Zhvillime më të rëndësishme në bilancin e pagesave¹ në tremujorin e parë të vitit 2021

Në tremujorin e parë të vitit 2021, transaksionet rrjedhëse me jorezidentë shënuan një deficit prej 61,2 milionë eurosh, kryesisht si rezultat i deficitit në shkëmbimin e mallrave edhe në saldon e të ardhurave parësore. Transaksionet financiare me jorezidentë kanë shënuar hyrje neto nga portfolio investimet, kreditë tregtare dhe huatë, dhe dalje neto nga investimet direkte dhe valutat dhe depozita.

(në milionë eruo)

	тековна година		претходна година		квартална промена		годишна промена	
	Кв.1 2021	Кв.1 2020	Кв.4 2020	милиони евра	%	милиони евра	%	
Тековна сметка	-61.2	-156.1	-72.4	11.2	-15.5	94.9	-60.8	
Стоки	-504.1	-546.3	-506.6	2.5	-0.5	42.2	-7.7	
Услуги	188.1	164.8	78.9	109.3	...*	23.4	14.2	
Примарен доход	-128.6	-100.4	-107.0	-21.6	20.2	-28.2	28.1	
Секундарен доход	383.3	325.8	462.3	-79.0	-17.1	57.5	17.7	
Капитална сметка	-3.7	0.3	3.6	-7.3		-3.9		
Финансиска сметка	-30.5	-170.6	-54.0	23.5		140.1		
Директни инвестиции	25.9	-135.9	-84.3	110.2		161.8		
Нето-стекнување средства	348.6	106.1	-271.9	620.5		242.5		
<i>Сопственички капитал**</i>	45.9	5.3	6.7	39.3		40.7		
<i>Реинвестирање на добивка</i>	1.7	3.2	2.1	-0.4		-1.5		
<i>Должнички инструменти</i>	301.0	97.6	-280.7	581.6		203.3		
Нето-создавање обврски	322.7	242.0	-187.5	510.3		80.7		
<i>Сопственички капитал**</i>	33.9	20.6	19.5	14.4		13.3		
<i>Реинвестирање на добивка</i>	95.5	86.3	-69.9	165.3		9.2		
<i>Должнички инструменти</i>	193.4	135.1	-137.2	330.6		58.2		
Портофолио-инвестиции	-636.9	31.6	239.5	-876.5		-668.5		
Валуту и депозити	28.0	71.8	111.4	-83.5		-43.9		
Заеми	-20.6	113.0	-132.8	112.2		-133.6		
Трговски кредити	-39.5	-1.9	-100.3	60.8		-37.7		
Девизни резерви	611.5	-249.3	-86.3	697.8		860.8		

...* процентуалната промена е над 100

** Сопственички капитал, освен реинвестирањето на добивката

Shënim: Në llogarinë financiare shenja (-) tregon hyrjet neto nga vendet e huaja. Tek rezervat valutore shenja (+) tregon rritje, ndërsa shenja (-) tregon zvogëlim të rezervave valutore. Ndryshimet e çmimeve dhe diferencat në kursin e këmbimit janë përjashtuar nga të dhënat për rezervat valutore.

Burimi: BPRMV.

¹ Bilanci i pagesave është një raport statistikor që përmbledh sistematikisht të gjitha transaksionet ekonomike të Republikës së Maqedonisë së Veriut me vendet e huaja për një periudhë të caktuar kohore, gjegjësisht i përmbledh transaksionet rrjedhëse, kapitale dhe financiare ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve.





Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Llogaria rrjedhëse

Në tremujorin e parët të vitit, në transaksionet rrjedhëse me jorezidentë, deficit është regjistruar në shkëmbimin e mallrave (504,1 milionë euro) dhe në të ardhurat parësore (128,6 milionë euro), i cili i tejkaloi hyrjet neto në të ardhurat dytësore dhe në shkëmbimin e shërbimeve (383,3 dhe 188,1 milionë euro, përkatësisht).

Krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar, deficitin e llogarisë rrjedhëse është zvogëluar me 94,9 milionë euro, si rezultat i hyrjeve të rritura neto në të ardhurat dytësore (për 57,5 milionë euro), deficitit të zvogëluar në shkëmbimin e mallrave (për 42,2 milionë euro) dhe tepricën e rritur në shkëmbimin e shërbimeve (për 23,4 milionë euro), në kushte të deficitit të rritur në të ardhurat parësore (për 28,2 milionë euro).



Burimi: BPRMV.

Llogaria financiare

Transaksionet financiare me jorezidentët, në tremujorin e parë të vitit 2021 shënuan hyrje neto prej 30,5 milionë eurosh. Prurjet më të konsiderueshme neto janë shënuar në portfolion e investimeve (636,9 milionë euro), kreditë tregtare (39,5 milionë euro) dhe huatë (20,6 milionë euro, ndërsa dalje neto në valuta dhe depozita dhe në investimet direkte (28 dhe 25,9 milionë euro, përkatësisht) Rezervat valutore shënojnë rritje për 611,5 milionë euro.

Në tremujorin e parë, aktivet në bazë të investimeve direkte shënuan një rritje prej 348,6 milion euro, si rezultat i pretendimeve të rritura në bazë të huave ndërkompani (301 milion euro), kapitalit (për 45,9 milionë euro) dhe riinvestimi i fitimi (1,7 milionë euro).





Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Detyrimet në bazë të investimeve direkte² shënojnë një rritje prej 322,7 milionë euro në tremujorin e parë, gjatë detyrimeve të rritura në të gjithë komponentët - huatë ndërkompani (193,4 milionë euro), riinvestimi i fitimit (95,5 milionë euro) edhe kapitali (33,9 milionë euro).

Në pajtim me ndryshimet e këtilla të aktiveve dhe detyrimeve, investimet direkte neto në tremujorin e parë të vitit 2021 shënuan dalje neto prej 25,9 milionë euro, si refleksion i huave ndërkompani (107,6 milionë euro) dhe kapitalit (12,1 milionë euro), në kushte të rritjes së hyrjeve neto në riinvestimin e fitimit (83,7 milionë euro).

Në tremujorin e parë të vitit 2021, detyrimet neto në bazë të portfolio investimeve janë rritur për 636,9 milionë euro, në masë të madhe si rezultat të huamarrjes së shtetit në tregun ndërkombëtarë të kapitalit, gjegjësisht si rezultat i hyrjeve nga emetimi i Euroobligacionit të ri. Detyrimet sipas portfolio investimeve në një pjesë janë ulur me zvogëlimin e detyrimeve të sektorit qeveri ndaj vendeve të huaja në bazë të pagesës së interesit në bazë të Euroobligacioneve të emetuara, si dhe blerjen e Euroobligacioneve nga emetimet paraprake nga ana e subjekteve rezidente vendore.

Në tremujorin e parë të vitit 2021, detyrimet neto në bazë të borxhit janë rritur për 20,6 milionë euro. Rritja në masë të madhe del nga përdorimi neto në sektorët tjerë³ (17,7 milionë euro), dhe më pak në sektorin institucione depozituese (3,2 milionë euro), ndërsa sektori qeveri shënon dalje neto (2,2 milionë euro).



Burimi: BPRMV.

² Paraqiten investime direkte në varësi të faktit nëse transakcionet financiare krijojnë detyrim ndaj ose të arkëtueshme (aktive) nga vendet e huaja.

³ Sektorët tjerë përfshijnë: institucione tjera financiare, ndërmarrje jofinanciare, amvisëri dhe institucione jofitimprurëse të cilat i shërbejnë amvisëritë.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Informacione shoqëruese

Seritë kohore të të dhënave: vjetore, tremujore dhe mujore për bilancin e pagesave

http://www.nbrm.mk/platen_bilans.nspix

Shpjegime metodologjike:

http://nbrm.mk/content/statistika/pb/metodologjia/Metodologjia_za_platen_bilans_5_2_2018.pdf

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimi të të dhënave

http://nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_na_objavuvanje_podatoci.pdf

Bilanci tremujor i pagesave: 31 gusht i vitit 2021 (mesatare referuese me korrikun e vitit 2021).

Për pyetje gazetarësh, ju lutemi kontaktoni me personat e Kabinetit të Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme lidhur me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit 02 3215 181 lokali 103 (ose 110/108).